



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ILDA V. SHARRA
ADRESA Rruga Sami Frasheri, Pallati
20, Shkalla1, Kati 1
TEL: 0682081313

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1402

Nr. koleksioni: 619

Tirane më 06/10/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

***Akti noterial përbëhet nga 4 fletë**



A2022053200062944235



A2022033200062944235

KONTRATË SHITJE KUOTASH



Në Tiranë, sot me datë 06 Tetor 2022 (dymije e njetete e dy), perpara meje noteres Ilda V. Sharra, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga " Sami Frashëri", u paraqitën personalisht palët e mëposhtme, të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate shitje kuotash, si më poshtë vijon :

SHITËSI

Shoqëria "AZ" Shpk, person juridik i regjistruar pranë QKB me datë 04/03/2015 me NUIS L51504014A, përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori i saj z. Artur Zeneli, atësia Fiqiri, amësia Hiqmete, lindur më 27/02/1968 në Burrel dhe banues në Tiranë, Rruga "Sheh Ahmet Pazari", Nd. 1, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga dokumenti personal i identifikimit Leternjoftim, ID me nr. 035973596 dhe nr. personal G80227059J, e cila në këtë kontratë është në cilësinë e ortakut zotërues të 50 % të kapitalit në Shoqërinë "Auto Manoku Servis" shpk, person juridik i regjistruar pranë QKB me datë 11.11.2016 dhe NUIS L62311016C.

DHE

BLERËSI:

Shoqëria "Automanoku" Sha, person juridik i regjistruar pranë QKB me datë 28.09.2009 dhe NUIS K92128001N, përfaqësuar nga aksioneri i vetëm dhe administratori i saj z. Albert Manoku, atësia Ruzhdi, amësia Minushe, lindur me 21/08/1966 në Lushnje dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Ndre Mjeda"; Nd. Igell; H. 3; Ap. 3073; Njësia Administrative Nr. 7; me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, shtetas shqiptar, për identitetin e të cilit u garantova nga dokumenti personal i identifikimit Leternjoftim ID me nr. 034513349 dhe nr. personal G60821082K, e cila në këtë kontratë është në cilësinë e ortakut zotërues të 50 % të kapitalit në Shoqërinë "Auto Manoku Servis" shpk, person juridik i regjistruar pranë QKB me datë 11.11.2016 dhe NUIS L62311016C.

Palët e mësipërme, bazuar në Kodin Civil të RSH, Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritëe Tregtare" të ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014, Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe statutit të Shoqërisë "Auto Manoku Servis" Shpk, deklaruan dhe kanë rënë dakord si më poshtë:

NENI 1

Objekti

Objekt i kësaj kontrate shitje është transferimi nëpërmjet shitjes të 50 % të kapitalit të zotëruar nga ortaku Shoqëria "AZ" Shpk në shoqërinë "Auto Manoku Servis" shpk në favor të ortakut tjetër shoqërisë "Auto Manoku" Sha.

Shoqëria "Auto Manoku Servis" shpk është person juridik, regjistruar në QKB me datë 11.11.2016, me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L62311016C, me seli në Tiranë, në adresë Lagjia Yrshek, Rruga "Nozllaku", Godine 2 Kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3865, Nr.Pasurie 287/28. Kapitali i Shoqërisë është 20.000 Euro (njetetë mijë) i zotëruar nga ortakët:

Artur Zeneli



A102205320006294235

1. Shoqëria "AZ" Shpk, zotëruese e 1 kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 Euro e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të Shoqërisë.
2. Shoqëria "Auto Manoku" Sha, zotëruese e 1 kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 Euro e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të Shoqërisë.

Me vendimin datë 06/10/2022 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Auto Manoku Servis" shpk, **është vendosur :**

1. Largimi nga shoqëria "Auto Manoku Servis" shpk i ortakut Shoqëria Shoqëria "AZ" Shpk.
2. Transferimin nëpërmjet shitjes të 1 kuote të zotëruar nga ortakut Shoqëria "AZ" Shpk me vlerë të përgjithshme 10.000 Euro të cilat përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë "Auto Manoku Servis" shpk tek ortakut tjetër Shoqëria "Auto Manoku" Sha.
3. Largimin nga detyra e administratorit të z. Artur Zeneli.

NENI 2

Përmbajtja e Kontratës

Shitesi Shoqëria "AZ" Shpk, me vullnet të lirë dhe të plotë i shet Blerësit Shoqëria "Auto Manoku" Sha, kuotën e zotëruar prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë "Auto Manoku Servis" shpk, me vlerë të përgjithshme 10.000 Euro (dhjetëmijë) e cila përfaqëson 50% të kapitalit në Shoqërinë "Auto Manoku Servis" shpk.

Blerësi Shoqëria "Auto Manoku" Sha, deklaroi se është plotësisht dakord të blejë nga shitësi Shoqëria "AZ" Shpk, kuotën e zotëruar prej tij në shoqërinë "Auto Manoku Servis" shpk.

NENI 3

Çmimi i Shitjes

Çmimi i shitjes së kuotës të zotëruar nga ortakut Shoqëria "AZ" shpk dhe që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate në favor të ortakut Shoqëria "Auto Manoku" Sha, është 10.000 Euro, shumë e cila është paguar nga blerësi dhe është transferuar nëpërmjet Bankës në llogarinë bankare të Shoqërisë "AZ" shpk, pranë Raiffeisen Bank ne numër llogarie 0021235428 .

Blerësi deklaroi se ka paguar plotësisht çmimin e shitjes jashtë kësaj zyre noteriale, dhe shitësi deklaroi se e ka marrë çmimin e plotë të shitjes dhe nuk ka asnjë pretendim.

NENI 4

4.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje shoqëria "AZ" Shpk zhvishet nga e drejta e pronësisë mbi kuotën e zotëruar prej saj në kapitalin themeltar të shoqërisë "Auto Manoku Servis" shpk, duke deklaruar se nuk ka asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e transferuara.

4.2 Pala Shitëse deklaroi se nuk ka asnjë pretendim për ndonjë të drejtë apo detyrim që rrjedh si rezultat i shitjes së kuotës që zotëron në shoqërinë "Auto Manoku Servis" sh.p.k

4.3 Pala Blerëse, Shoqëria "Auto Manoku" Sha, bëhet zotëruese e 1 kuote me vlerë të përgjithshme 20.000 Euro, e cila përfaqëson 100 % (njëqind) të kapitalit të Shoqërisë "Auto Manoku Servis" shpk me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart pronësia e kuotave të blera duke fituar njëkohësisht dhe cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.



A2022053200062944235

NENI 5

Modalitete e shitjes

5.1 Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bien dakort që të gjitha detyrimet ndaj të tretëve që shoqëria "Auto Manoku Servis" shpk ka nga krijimi i saj e deri në momentin e kalimit të pronësisë nga pala Shitëse tek pala Blerëse, janë përgjegjësi e palës blerëse dhe pala shitëse nuk ka asnjë detyrim ndaj të tretëve apo ndaj palës blerëse në lidhje me to.

5.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pronësia mbi Kuotën e palës shitëse dhe të drejtat e tjera që lidhen me to dhe ose rrjedhin prej tyre, përfshirë të drejtën e votës dhe të dividendit si dhe të drejtat në administrimin e Shoqërisë i kalojnë palës Blerëse dhe pala Shitëse zhvishet tërësisht prej tyre.

5.3 Palët deklarojnë dhe bien dakort se kuotat janë të lira nga çdo pretendim i të tretëve, nuk është e rënduar me barrë apo të ketë proces gjyqësor në lidhje me pronësinë, konfirmuar dhe nga rezultati i kërimit në RBS.

NENI 6

Të ndryshme

6.1 Forma e likujdimit për shitjen e kuotës është kryer jashtë zyrës noteriale nëpërmjet trasaksionit bankar në llogarinë bankare të Shitësit.

6.2 Kjo Kontratë përgatitet dhe nënshkruhet në katër kopje origjinale me vlerë të njëjtë juridike secili dhe ky akt përbën të gjithë marrëveshjen e arritur midis Palëve.

Kësaj kontrate i bashkëlidhet:

- a) Vendimi i asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë "Auto Manoku Servis" shpk,
- b) Ekstrakti i Regjistrimit Tregëtar, mjete identifikuese,
- c) Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë.
- d) Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese

NENI 7

Ligji Zbatues dhe Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

7.1 Për çështjet të cilat nuk janë parashikuar në këtë Kontratë apo që mund të rrjedhin prej saj do të zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë i cili është ligji i zbatueshem për këtë Kontratë.

7.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve të kësaj Kontrate në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, nëse nuk zgjidhet në mirëkuptim mes Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të Ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.



A2022053200062944235

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITËSI
SHOQËRIA "AZ" SHPK
Përfaqësuar nga Artur ZENELI

Artur Zeneli



BLERËSI
SHOQËRIA "AUTO MANOKU" SHA
Përfaqësuar nga Albert MANOKU

Albert Manoku



NOTERE

Glenn V. Shavira




REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-2022100515529287
Data e Rezultatit te Kerkimit: 05.10.2022
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 3:52:09PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-013-4207
Referenca e Pendoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI D

AZ SH.R.K.



Florinda Dush